Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0834

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "DataProgNet" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA" me numër të prokurimit 214-24-7283-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, më 11.11.2024, mori këtë:

Vendim

1.Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE"DataProgNet" SH.P.K., me nr. 2024/0834, e datës 13.09.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA" me numër të prokurimit; 214-24-7283-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

2.Mbetet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin (B58) të Autoritetit Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme, në lidhje me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën një (1) të vendimit.

3.Konfiskohet tarifa e ankesës në vlerën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndaj operatorit ekonomik ankues OE "DataProgNet" SH.P.K., bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 16.07.2024 Ministria e Punëve të Brendshme., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA" me numër të prokurimit 214-24-7283-2-2-1.

Me 30.08.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE “Global CT Digital Kosovo SH.P.K.”, përaktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA” me numër të prokurimit 214-24-7283-2-2-1.

Me 03.09.2024, OE "DataProgNet" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 05.09.2024.

Me 13.09.2024, OE "DataProgNet" SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2024/0834, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "DataProgNet" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I): Operatori ekonomik “DataProgNet” SH.P.K.” pretendon se AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, Nenin 7 dhe Nenin 59 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), pasi vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.

Në përgjigje të pretendimeve ankimore nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës “Global CT Digital Kosovo SH.P.K.”:

Sipas OE ankues, AK ka propozuar për kontratë një OE që nuk ka ofruar deklaratë për mirëmbajtje dhe avancim, deklaratë për specifikacion teknik, si dhe nuk ka paraqitur zgjidhje më të hollësishme të sistemit, si Plani Dinamik dhe Propozimi Teknik, të cilat ky operator ekonomik i konsideron të detyrueshme për çdo ofertues, duke marrë parasysh rëndësinë e projektit në fjalë. Nga analiza e dokumenteve zyrtare, OE “DataProgNet” SH.P.K. pretendon se, në mungesë të dokumenteve të lartpërmendura, OE i propozuar për kontratë “Global CT Digital Kosovo SH.P.K.” nuk e ka të qartë se për çfarë ka ofertuar. Kjo është arsyeja pse oferta financiare nuk korrespondon fare me çmimin e tregut dhe as me planifikimin e AK-së, duke pasur parasysh përgjegjësinë dhe rëndësinë e projektit.

Pretendimi i dytë (II): “DataProgNet” SH.P.K. pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional si në vijim:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 3: Një (1) ekspert për zhvillimin e bazave të të dhënave duhet të ketë diplomë në Inxhinierinë Kompjuterike, Shkencat Kompjuterike ose Fakultetin e Kompjuterikës me Telekomunikacion, si dhe minimum 3 vite përvojë pune në zhvillimin e bazave të të dhënave në projekte të natyrës së ngjashme, të zhvilluara në platformën Microsoft (baza e të dhënave në

SQL Server). Ai/ajo duhet të ketë qenë pjesëmarrës në së paku tri (3) projekte në zhvillimin e bazave të të dhënave.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Diploma përkatëse
2. CV e nënshkruar nga inxhinieri (origjinal)
3. Kontrata ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje)
4. Referencat për përvojën e punës nga punëdhënësit (kopje)
5. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën në projektet e realizuara

Pretendimi i tretë (III): Sipas OE ankues, "Global CT Digital Kosovo SH.P.K." nuk ka plotësuar as kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional si në vijim:

Kërkesa 4: Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses së paku një projekt në fushën e shërbimeve të ngjashme, në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 60,000.00 €, të realizuar në tri vitet e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

4. Lista e projekteve të përfunduara (origjinal) e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projektet e realizuara, duke bashkëngjitur referencat ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve, duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit të projektit.

Pretendimi i katërt (IV): OE ankues pretendon se, gjithashtu, Operatori Ekonomik Tretek SH.P.K., pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, nuk ka dorëzuar deklaratë për mirëmbajtje dhe avancim, deklaratë për specifikacion teknik, si dhe nuk ka ofruar zgjidhje më të hollësishme të sistemit, si Plani Dinamik dhe Propozimi Teknik. Sipas OE ankues, Operatori Ekonomik Tretek SH.P.K. nuk plotëson as kërkesën si në vijim:

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

a. Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor (të hyrat) e OE-së për periudhën e shkuar trevjeçare (2021, 2022, 2023) ka qenë jo më pak se 80,000.00 €.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës (ose në vendin e themelimit të OE-së) për periudhën e shkuar trevjeçare.

- AK/Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Tenderuesi, DataProgNet SH.P.K, Ferizaj, sipas kërkesës për qasje në dokumentacionin e tenderit, është shpallur fitues, dhe i është dorëzuar dokumentacioni i kërkuar nga AK-MPB-ja. Si palë e pakënaqur, tenderuesi ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK përmes platformës elektronike më datën 03.09.2024, kundër njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, për tenderin: Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA, duke pretenduar se janë bërë shkelje të

Neneve 1, 7 dhe 59 të LPP-së.

1. Përgjigje në pretendimin e lartcekura (Neni 1, Qëllimi) Ministria e Punëve të Brendshme, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e pretendimit dhe ka konstatuar se pretendimi i Autoritetit Kontraktues është i pabazuar, sepse gjatë vlerësimit, Autoriteti kontraktues i është përmbajtur këtij Neni dhe ka arritur qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, siç është paraparë në Nenin 1 të LPP-së.
2. Përgjigje në pretendimin e lartcekut (Neni 7) Pretendimi i tenderuesit ankues DataProgNet SH.P.K., Ferizaj, thotë se AK me rastin e vlerësimit të tenderëve ka shkelur Nenin 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim/Diskriminimi, është i pabazuar, sepse gjatë vlerësimit, AK ka konstatuar se tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm. Komisioni vlerësues ka konstatuar se tenderi juaj, në shqyrtimin analitik të çmimit të ofruar, krahasuar me çmimin e planifikuar nga njësia kërkuese, me ofertat e tjera dhe çmimin e tregut, është çmim i ofruar jashtëzakonisht i lartë dhe i papranueshëm. Ky çmim i ofruar është në kundërshtim me Nenin 4 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Andaj, në këtë rast, AK me eliminimin tuaj nga ky aktivitet i prokurimit ju ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe nuk kemi të bëjmë me kurrfarë diskriminimi apo favorizimi ndaj asnjë operatori ekonomik pjesëmarrës, prandaj në këtë rast nuk kemi të bëjmë me shkelje të Neni 7 të LPP-së.
3. Përgjigje në pretendimin e lartcekur (Neni 59) Pretendimi i tenderuesit ankues, për tenderuesin e shpallur fitues (Global CT Digital Kosovo SH.P.K.), se nuk është i përgjegjshëm, ky konstatim është i pabazuar sepse AK, me rastin e vlerësimit të tenderëve, ka vlerësuar tenderin e tij me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës, në dosjen e tenderit. AK gjatë vlerësimit të tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit iu ka përmbajtur dhe ka zbatuar Nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së, i cili thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyetimeve në vijim:

- Tenderi juaj është administrativisht i papërgjegjshëm.
- Tenderi juaj përmban çmime që tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit.
- Tenderi juaj është i papërgjegjshëm dhe është refuzuar, sepse është në kundërshtim me Nenin 62, pika 2 e LPP-së, sepse oferta juaj financiare e tejkalon në mënyrë substanciale buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Për këtë arsye, tenderi juaj nuk është shqyrtuar dhe vlerësuar nga komisioni i vlerësimit dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtejshëm.

Në zbatim të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, Ministria e Punëve të Brendshme nxjerrë këtë përfundim:

Konkluzion: I refuzohet si i pabazuar Kërkesa për rishqyrtim e Tenderuesit DataProgNet SH.P.K.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

-Lidhur me pretendimet e OE "DataProgNet" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0834 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumenteve në platformën elektronike të prokurimit, ka gjetur se në ofertën e OE të propozuar për kontratë është dorëzuar një deklaratë për specifikacion teknik e nënshkruar dhe e vulosur, si dhe një deklaratë për mirëmbajtje dhe avancim e nënshkruar dhe e vulosur (megjithëse kjo e fundit nuk ka qenë kriter për dhënien e kontratës). Ndërsa sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar zgjidhje më të hollësishme të sistemit, si Plani Dinamik dhe Propozimi Teknik, Eksperti shqyrtues sqaron se të dy këto kërkesa nuk kanë qenë kritere për dhënien e kontratës, të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit.

Konstatimi i dytë (II): Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumenteve, sqaron se pretendimi i OE ankues lidhur me kërkesën për Ekspertin për Zhvillimin e Bazave të të Dhënave nuk qëndron. OE "Global CT Digital Kosovo SH.P.K." ka ofruar dëshmi se eksperti i propozuar për këtë projekt është diplomuar dhe posedon titullin Inxhinier i diplomuar në Teknologjinë e Informacionit.

Konstatimi i tretë (III): Eksperti shqyrtues ka analizuar me kujdes pretendimin e OE ankues se AK - Ministria e Punëve të Brendshme, ka rekomanduar për dhënie të kontratës një OE që nuk ka ofruar listën e projekteve të përfunduara, origjinal të vulosur dhe të nënshkruar, dhe sqaron se ky pretendim nuk qëndron. Lista e kontratave e nënshkruar dhe e vulosur, sipas kërkesës së AK-së, është gjetur në ofertën e "Global CT Digital Kosovo SH.P.K."

Konstatimi i katërt (IV): Eksperti shqyrtues, pas analizimit të dokumenteve në platformën elektronike të prokurimit, ka gjetur se në ofertën e OE është dorëzuar specifikacioni teknik i nënshkruar dhe i vulosur. Ndërsa sa i përket pretendimeve të tjera, eksperti sqaron se këto kërkesa nuk kanë qenë kritere për dhënien e kontratës, të përcaktuara në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues nuk qëndron. OE ka dorëzuar Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për vitet 2022 dhe 2023, të cilat dëshmojnë qarkullimin mbi vlerën e përcaktuar nga AK-ja.

Ndërsa sa i përket pretendimit të OE ankues, se Tretek SH.P.K. nuk ka dorëzuar listën e stafit origjinal të nënshkruar dhe të vulosur, eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa në fjalë nuk ka qenë kriter për dhënien e kontratës, të përcaktuar në njoftimin e kontratës/dosjen e tenderit.

Gjithashtu, eksperti shqyrtues nuk ka gjetur se mjetet e vëna në dispozicion nga AK-ja nuk janë në harmoni me kërkesën. Për këtë aktivitet të prokurimit, AK ka pranuar gjithsej 4 (katër) oferta, 3 (tri) prej tyre nën buxhetin e përcaktuar nga AK-ja.

Mbështetur në atë që u tha më lart, eksperti shqyrtues konstaton se nuk janë gjetur shkelje të Nenit 1, Nenit 7 dhe Nenit 59 të LPP-së, ashtu siç pretendon OE ankues lidhur me rekomandimin e AK-së për dhënie të kontratës.

Rekomandimi i eksperit shqyrtues sipas raportit;

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 13.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/0834, ndërsa me datë 20.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0834 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE"DataProgNet" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht

dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE"DataProgNet" SH.P.K.janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, te paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues të dates 30.08.2024 per të shperblyer me kontratë. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pa bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e OE"DataProgNet" SH.P.K, duhet refuzohet si e pa e bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates 30.08.2024 për aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar ,Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit SERA" me numër të prokurimit 214-24-7283-2-2-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/0834, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE"DataProgNet" SH.P.K të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **"DataProgNet" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: